



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punë/Pradato Received/Delivered | 16.06.2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Bjësia Org./Jedinka Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SHKUPSHICK | 4798/2023 | | 116 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.706/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.706/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike “kundërshtim i vlerësimit të rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 16.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa A.nr.706/2023 e datës 04.05.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. *Ndryshohet* Formulari i datës 03.05.2023 për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen, lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit, dhe atë nga nota 2.44-mjaftueshëm, në notën 3-mirë.
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesen si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civile.
- IV. *Obligohet* Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njësisë së Birimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Ferizajt (*tutje vetëm ankuesja*) më datë 04.05.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021 të datës 03.05.2023, më pretendimin ankimor së rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 nga Drejtoresha e Qendrës për Punë Sociale është jo profesional, tendencios dhe i pa bazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Ferizajt, ndërsa, kjo e fundit me datë 23.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 4044/2023 e datës 04.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për shfrytëzimin e pushimit vjetor për vitin 2020 e datë 18.02.2021; Vendimin me numër reference 01 IN Nr.463/21 i datës 05.02.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 03.05.2023; Emailin e datës 03.05.2023 nga ankuesja për Emailin e datës 15.06.2021 nga për ankuesen; Emailin e datës 22.04.2021 nga për QPS Ferizaj dhe Referencën e datës 21.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 23.05.2023; Akt Emërimit e datës 01.07.2021 për ankuesen; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesen; Emailin e datës 17.05.2023 nga për Procesverbalin e datës 03.05.2023; Emailin e datës 11.08.2021 nga ankuesja për dhe ; Procesverbalin mbi takimin mes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe QPS Ferizaj i datës 19.08.2021; Shkresën nga Qendra për Punë Sociale në Ferizaj për Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega Vushtrri; Emailin e datës 13.08.2021 nga ankuesja për QPS Ferizaj; Emailin e datës 26.07.2021 nga ankuesja për ; Emailin e datës 26.07.2021, 13.08.2021 nga për ankuesen; Formën e vlerësimit për shfrytëzuesit e shërbimeve sociale e datës 18.02.2021; Procesverbalin e Qendrës për Punë Sociale i datës 10.08.2021; Shkresën më titull Intervenimet e Përgjithshëm nga Menaxheri i Rastit të QPS-së; Lista e hyrje/daljeve në punë e datës 25.02.2021, 26.01.2021, 27.01.2021, 28.01.2021, 29.01.2021, 01.02.2021, 02.02.2021, 03.02.2021, 04.02.2021, 05.02.2021, 22.02.2021, 23.02.2021, 24.02.2021, 25.02.2021, 26.02.2021, 01.03.2021; Vendimin A.nr.419/2023 i datës 12.04.2023 i Këshillit; Ankesën me numër protokoli 2068/2023 e datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën për pranidorëzim e datës 14.06.2022; Emailin e datës 06.01.2023 nga ankuesja për dhe Emailin e datës 20.04.2022 dhe 28.04.2021 nga për ankuesen; Emailin e datës 28.04.2021 nga Emailin e datës 17.05.2021 nga për Emailin e datës 17.05.2021 nga Emailin e datës 23.03.2021 nga Emailin e datës 19.03.2021 nga ; Emailin e datës 02.12.202 nga për ankuesen; Emailin e datës 12.21.2022 nga ankuesja për dhe) Plotësimin e ankesës e datës 28.02.2023; Emailin e datës 21.12.2022 nga për Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoli 2399/2023 e datës 06.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokoli 2641/2023 e datës 14.03.2023; Raportin e punës për vitin 2021 i datës 31.12.2021 nga ankuesja; Njoftimin me Nr. 02-278/1 të datës 19.03.2021 nga ankuesja; Emailin e datës 15.06.2021 nga për ankuesen; Emailin e datës 22.04.2021 nga Formularin për

vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 23.02.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 23.02.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 i datës 20.01.2023; Vendimin për transferimin e përhershëm të ankueses me numër 01Nr.01-02/20 i datës 22.01.2020; Vendimin me Nr.02-131/03-0114161/21 i datës 01.10.2021 për pushim të lehonisë për ankuesen; Vendimin me Nr.02-130/-01-0019527/22 të datës 25.02.2022 për shfrytëzimin e pjesës së dytë dhe tretë të pushimit të lehonisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuar pretendimet ankimore të ankueses:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesja në bazë të Aktit të Emërimit të datës 01.07.2011 është emëruar në pozitën *Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë* në Komunën e Ferizajt, ndërsa sipas Vendimit me numër 01 Nr.01-02/20 të datës 22.01.2020 të Kryetarit të Komunës, është transferuar në mënyrë të përhershme nga pozita *Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë* në pozitën *Zyrtare për Shërbime Sociale*.

Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankueses, me datë 23.02.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021, me notë të përgjithshme 2.44. Ankuesja i pakënaqur me këtë vlerësim ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.419/2023 të datës 12.04.2023, ka shfuqizuar formularin e vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 23.02.2023 dhe ka detyruar Drejtorin e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Ferizajt që të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021.

Duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.419/2023 të datës 12.04.2023, Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Ferizajt, më datë 03.05.2023 ka bërë ri vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021, duke e vlerësuar të njëjtën me notë të përgjithshme 2.44-mjaftushem.

Ankuesja e pakënaqur me rivlerësimin e datës 03.05.2023, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më bazë ankimore së vlerësimi i datës 03.05.2023 është jo profesional, tendencioz dhe i pa bazuar. Shton së mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me rastin e konstatimit se kam munguar në punë në kohë të caktuara nuk është bazuar në asnjë provë materiale për shkak që kam qenë në pushim vjetor apo kam qenë në izolim nga COVID-19. Me rastin e rivlerësimit prezent në këtë proces kanë qenë Ushtruesi i detyrës për Skemën Sociale në Institucionin e Qendrës për Punë Sociale dhe asistentja e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky vlerësim bie në kundërshtim me referencën e datës 21.04.2022 të lëshuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Kolegji në kuptim të vendosjes meritore i'u referua nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: "1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2.

Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit...".

Po ashtu Kolegji i Këshillit mori parasysht edhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, përkatësisht nenin 5 ku përcaktohet se: "Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë pasues. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë".

Referuar kuadrin ligjor si me sipër, e në mbështetje të provave të lëndës nuk vërtetohet fakti se është aprovuar plani individual i punës për ankuesin për vitin 2021, i cili plan përmban objektivat e punës dhe aktivitetet për përmbushjen e këtyre objektivave. Rrjedhimisht objektivat e punës përcaktohen nga mbikëqyrësi në këtë rast Drejtori i Qendër për Punë Sociale në bashkëpunim me ankueses dhe së vlerësimi vjetor i rezultateve të punës bazohet në përmbushjen e objektivave sipas planit individual të punës së nëpunësit civil. Andaj, mos përgatitja dhe mungesa e planit objektiv të punës bie ndesh me përcaktimin ligjor sipas 6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, me të cilin parashihet se: "Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet. 2. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë. 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit. 5. Në rast ndryshimi të objektivave brenda vitit të vlerësimit, zhvillohet e njëjta procedurë sipas paragrafëve 1 deri 4 të këtij neni për pjesën e mbetur të vitit të vlerësimit".

Po ashtu nga analizimi Formularit të vlerësimit të rezultateve në punë të datës 03.05.2023 dhe shkresave të lëndës rrjedhë së mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike lidhur me prezencën e ankueses në punë, rrjedhimisht mbikëqyrësja e ankueses ka

konstatuar se "ankuesja nga data 05.01.2021 deri 22.01.2021 ka vijuar punën, nga data 25.01.2021 deri më datë 05.02.2021 nuk ka vijuar punën, nga data 08.02.2021 deri më datë 19.02.2021 ka vijuar punën, nga data 22.02.2021 deri më datë 01.03.2021 nuk ka vijuar punën dhe nga data 02.03.2021 deri më datë 25.03.2021 ka vijuar punën, ndërsa në bazë të provave të lëndës përkatësisht sipas Vendimit me numër Reference 01 IN Nr.463/21 të datës 05.02.2021 të Inspektoratit Sanitar të Komunës së Ferizajt vërtetohet se ankuesja është liruar nga izolimi për shkak të infektimit me COVID-19, kështu që mbi këtë fakt dhe duke marrë përsydh praktiken e zbatuar ku të infektuarit me COVID kanë qëndruar në izolim 1 deri 2 javë, rrjedhë së ankuesja ka munguar në punë për periudhën nga data 25.01.2021 deri më datë 05.02.2021 për shkak të izolimit nga infektimi me virusin Covid-19, ndërsa për mungesë në punë për periudhën nga data 22.02.2021 deri më datë 01.03.2021 ankuesja ka të aprovuar pushimin vjetor për këtë periudhë nga mbikëqyrësi i saj, kurse për përdhën nga 26 mars deri me 06 shtator 2021 ankuesja ka qenë e liruar nga prezenca fizike në punës sipas Vendimeve të Qeverisë së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 pasi që e njëjta ka qenë shtatzëne duke vazhduar me tej nga data 07.09.2021 me pushim të lehonisë, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses për këtë çështje janë të paqëndrueshme të pa argumentuara.

Lidhur me konstatimin e vlerësueses së ankuesja ka menaxhuar një numër shumë të vogël të rasteve, Kolegji nga vlerësimi i shkresave të lëndës ka gjetur së ky konstatimi mbikëqyrës është i pa argumentuar për faktin së mbikëqyrësja e ankueses ka dhënë konstatim të përgjithshëm pa specifikuar në mënyrë individuale se cilat janë rastet/detyrat që ankueses i janë bart për realizim, cila ka qenë periudha e realizimit të tyre, dhe njëkohësisht cila raste nuk janë realizuar nga ankuesja. Ndërlidhur me këtë Kolegji thekson faktin së mbikëqyrësja e ankueses më rastin e vlerësimit nuk ka marrë parasysh faktin notor se i tërë viti 2021 ka qenë i përcjell me gjendjen e pandemisë COVID-19 ku bazuar në politikat qeveritare, institucionet publike kanë punuar me masa të mbrojtjes dhe kontrollit duke përfshirë edhe punën online të kategorive të caktuara të zyrtareve publike, siç ka qenë rasti me nëpunëset shtatzëna, rrethana këto që në përgjithësi kanë reflektuar në përmbushjen e objektivave të punës jo vetëm në nivel të zyrtarëve por në nivel të tërësishëm të institucioneve publike.

Referuar pretendimit të mbikëqyrëses së ankueses së ankuesja nuk ka kontribuar në përmbushjen detyrimeve të saj ligjore dhe kryerjen e punëve dhe së nga mungesa e saj në punë lëndët e saj, kanë kaluar për trajtim të zyrtarët e tjerë, nga analizimi i provave materiale të çështjes nuk vërehet fakti nëse ankuesja kishte refuzuar përmbushjen e detyrave të punës apo që nga ana e udhëheqësja e saj të jetë dhënë ndonjë sugjerim apo vërejtje gjatë periudhës së vlerësimit për mos përmbushje të këtyre detyrave të punës nga ana e ankueses. Në këtë kontekst Kolegji po nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur së rastet e ankueses gjithsej 23 sosh i janë bart për realizimi zyrtarëve tjerë pasi që ankuesja kishte filluar me pushim e lehonisë, kështu që pretendimi i mbikëqyrëses nuk ka mbështetje faktike.

Për vendosje të drejtë dhe të ligjshme Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe vlerësimet e punës për vitin 2020 dhe 2023 të ankueses, ku ankuesja për vitin 2020 ka vlerësim të punës me notë të përgjithshme 4.29-shumë mirë si dhe për vitin 2023 vlerësimin e përgjithshëm 4.12-shumë mirë, si dhe Referencën me numër protokolli QPS-594 të datës 21.04.2022 të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses sipas të cilës është dhënë vlerësimi së ankuesja nga

themelimi i marrëdhënies së punë në këtë pozitë me datë 24.01.2020 është treguar e përpiktë me klientë e qendrës dhe e përpiktë në detyrat e saja të cilat janë caktuar dhe ka treguar përkushtim në ofrimin e shërbimeve.


Andaj bazuar në konstatimet dhe rrethanat si me lartë, si dhe duke marr parasysh Raportin e punës për vitin 2021 të datë 31.12.2021 të dërguar nga ankuesja për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, Kolegji i Këshillit vlerëson së vlerësimi i rezultateve të punës së ankueses me notën e përgjithshme 2.44-*mjaftueshëm* nuk është vlerësim i drejtë, kështu që në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: “Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)..”, Kolegji vendosi që të ndryshoj Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, për ankuesen, ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare 2.44, ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare 3, e që në kuptim të nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nota nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton vlerësimin “mirë”.

Theksuar si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.706/2023

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.